



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA POLICAN
NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK**

Nr _____ Prot

Data 10 / 11/2025

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Studim hartim projektsh”me objekt :

- *"Asfaltim i rruges Karkanjoz-Tomorr i Madh- Tomorr i Vogel” , BASHKIA POLIÇAN*
- *"Asfaltim i rruges se brendeshme te Fshatit Kapinove” , BASHKIA POLIÇAN*
- *"Ndertimi i rruges lidhese "Mbrakull – Rruga e Re Berat - Skrapar”*
- *"Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rruges Gradisht-Peshtan NJA Vertop” , Bashkia Poliçan*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):)-

- Projekte 22114311-5

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës eshte 15 994 253 (pesembedhjete milion e nenteqind e nentehjete e kater mije e dyqind e pesedhjete e tre)leke **Monedha, pa TVSH.**

Fondi i përlllogaritur për vitin buxhetor 2025 është : 6 666 667 (**gjashte milion e gjashteqind e gjashtedhjete e gjashte mije e gjashteqind e gjashtedhjete e shtate**) lekë pa TVSH.

Fondi i përlllogaritur për vitin buxhetor 2026 është: 9 327 586 (**nente milion e treqind e njezete e shtate mije e peseqind e tetedhjete e gjashte**) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Polican ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 ;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme :

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas pikes 1 te shtojces 09 (Kriteret e Pergjithshme per Kualifikim).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 3, 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës objekt prokurimi.

. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/entikontraktor. Në çdo rast Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetës për këto sqarime

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është e Hapur e Prokurimit të Shërbimeve , përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa "b" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: vlerën e përlllogaritur të kontratës në procedurën e prokurimit "Te Hapur e Prokurimit të Shërbimeve" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë bazuar është bërë bazuar në mbështetje të nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.1 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2022,2023,2024) që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Operatorët Ekonomike ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2025 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas adreses kryesore dhe dytesore të shënuar në QKB sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar).

Në rastet e bashkimit të OE, çdo anëtar i grupit BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse, për vitin vitin 2025 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (Sipas QKB).

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas bashkëve të operatorit ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e formularit të Vetdeklarimit. Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3 .Kriteri teknik

2.3.1 Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar , dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimoreku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b)Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese të shitjes , të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “E hapur shërbim” si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:

- kat 2. PROJEKTUES ARKITEKT
d-Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.
- Kat 3 PROJEKTUES KONSTRUKTOR
c)Projektim:1. Objekte me shkallë të lartë vështiresie Beton-arme-metalike
-2. troje dhe shpate me qendrueshmeri të ulet.
- kat5. PROJEKTUES VEPRRA HIDRAULIKE
b.Projektim furnizimi me uje- kolektore shkarkimi

- kat 6 PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA
 - a- Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- kat 8. PROJEKTUES GJEODET
 - a) Rilevime inxhinierike
 - b) Rivelim inxhinierike kadastrale
 - c) Sistemi GIS
 - d) Bazamente gjeodezike
 - e) Projektim fotogrametrik dhe hartografik
- kat 9. STUDIME GJEOLOGJIKE INXHINIERIKE-HIDROGJEOLOGJIK
 - d- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
- Kat 10 PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TE PRODHIMIT DHE SHPERNDARJES SE ENERGJISE ELEKRIKE
 - e)Projektim gabina elektrike te rrjetit shperndares-linja te tensionit te ulet-te mesem
- Kat 11 PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR
 - d- Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.
- Kat.12. STUDIME TE SIZMOLOGJISE INXHINIERIKE
 - c- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtese.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”* (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Vlerësojmë që operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm dhe të pranueshëm cilësie.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik në licensën e shoqërisë stafin si më poshtë dhe të jenë të përfshirë në listëpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave .
Për stafin e mesipër Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- 1 (nje) arkitekt
- 1 (nje) inxhinier ndërtimi profili strukturist/Civil
- 1 (nje) Inxhinier Profili Rruge, ura
- 1 (nje) inxhinier gjeodet/Markshaidër
- 1 (nje) inxhinier gjeolog
- 1 (nje) inxhinier elektrik
- 1 (nje) inxhinier mekanik

Për stafin e mesipër Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme),
- Licencat profesionale,
- Diplomë,
- CV ,
- të firmuara në Listëpagesat e Shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave .

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (shtojca 5)

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar dhe deklaratat e disponueshmërisë së stafit.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të referencës për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

- Punimet per sherbimin e projekteve strukture kane gjithashtu nje volum te rendesishem, pasi kryesisht parashikohet te kemi realizim te objekteve me shkalle te ndryshme veshtiresie te cilat kerkojne gjykim dhe punime te specializuara ne fushen e projektimit strukturor per te cilen kerkohet dhe staf ndihmes. Inxhinieri i ndertimit do te duhet dhe ne projektimin e nderhyrjeve te reja si rrjedhoje gjykohet qe duhet te pakten **1 (nje) inxhinier ndertimi , profili strukturiste** pjese e stafit teknik.
- Ne Detyra projektimi jane prashikuar dhe rehabilitime per 4 rruge, ndaj eshte kerkuar disponimi i te pakten 1 drejtues teknik **ndertimi , profili Profili Rruge, ura**
- Sherbimet per projektimin arkitektonik priten te kene nje volumen te moderuar te projekteve te kesaj procedure, si projektim peisazhi, sistemim siperfaqe te gjelberta , lulishte e parqe per te cilen gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 nje Arkitekt** si staf teknik .
- Punimet per sherbimin e projektimit topografik do te jene nje ze i rendesishem ne realizimin e projekteve qe parashikohen te kene dhe volume te konsiderueshme te punimeve topografike si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 nje gjeodet** si pjese e stafit teknik.
- Punimet per sherbimin e projektimit te studimeve gjeologjike dhe hidrologjike qe parashikohen bazuar ne termat e references, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 nje inxhinieri gjeolog** si pjese e stafit teknik.
- Punimet per sherbimin e projektimit te sistemeve elektrike parashikohen bazuar ne termat e references, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 nje inxhinieri elektrik**, si pjese e stafit teknik.
- Punimet per sherbimin e projektimit te sistemeve meknike parashikohen bazuar ne termat e references si sinjalistik rrugore etj, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 nje inxhinieri mekanik** , si pjese e stafit teknik.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete si staf mbështetës ku te figurojne 3 muajt e fundit ne listpagese te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si dhe te paraqites dokumentat ,Kontratat individuale te punes (të vlefshme),Diplomë, CV, per stafin si më poshtë:

- 1(nje) Inxhinier Profili Rruge ura/Transport
- 1(nje) Inxhinier Ndertimi Profili Strukturist/Civil
- 1(nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1(nje) Inxhinier Gjeodet/Markshaider/Gjeomatik
- 1 (nje) punonjes te pajisur me certifikate si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune" ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10237, date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"
- 1 (një) punonjes i pajisur me Certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- 1 (nje) punonjes i pajisur me certifikate leshuar nga ISTN per testimin e performaces se produkteve te ndertimit.

Per stafin mbeshtetes Inxhinier Profili Rruge ura/Transport, dhe inxhinier Ndertimi Profili Strukturist/Civil pervec dokumentave si ,Kontratat individuale te punes (të vlefshme),Diplomë, CV se dhe te figurojne 3 muajt e fundit ne listpagese te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, duhet te paraqesin edhe licence individuale per projektim .

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar dhe deklarata e disponueshmerise se stafit.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te references, natyres se pergjithshme te sherbimeve qe priten te ofrohen. Meqenese kemi te bejme me kater objekte kompleks sic jane ndertimi i rrugeve te

fshatrave , prezenca e stafit te mesiperm eshte gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme per nje shperndarje dhe efikasitet sa me te madh ne realizimin e sherbimeve konkretisht;

- **1 nje punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, eshte i domosdoshem per realizimin e VNM (Vleresimet e ndikimit ne Mjedis) per projektet qe do te realizohen.
- **1 nje punonjes te pajisur me certificate si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune"** ne perputhje me klauzolat e ligjit 10237, date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" pasi natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë.
- **1(nje) inxhinier Gjeodet/Markshaidet/Gjeomatik** eshte i nevojshme per hartim projektesh dhe perpunim te dhena per projekt Topografik, gjeodezik etj
- **1 (nje) inxhinier i pajisur me certificate leshuar nga ISTN per testimin e performaces se produkteve te ndertimit** Eshte i nevojshem per perzgjedhjen e materialeve sa me te mira .
- **1(nje) Inxhinier Profili Rruge ura/Transport** eshte per ti ardhur ne ndihme drejtuesve teknik per perpunim te dhenasht per rruget objekt prokurimi.
- **1(nje) Inxhinier Profili Strukturist/civil** eshte per ti ardhur ne ndihme drejtuesve teknik per perpunim te dhenasht per bazamentet mbrojtese dhe mbajtese te rrugeve qe jane objekt prokurimi.
- **1(nje) Inxhinier Hidroteknik** eshte i nevojshem per hartim projekt hidroteknik dhe perpunim te dhenash me natyre hidroteknike.

2.3.5.Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqes nje liste te personelit kryesor dhe stafit mbeshtetes ku te specifikohen emrat dhe profili , qe do te angazhohen ne kete objekt prokurimi.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 14(katërmbëdhjetë) punonjës për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhen e 3 muajve te fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- b) Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e 3 muajve te fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kerkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Termave të References. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri i mesiper perkon me stafin që pritet të jetë i angazhuar në këtë procedurë.*

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur dhe te paraqese Certifikatat te pershtatshme ose ekuivalentet e tyre per objektin e prokurimit si me poshte:

- a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise;
- b) ISO 14001: 2015, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit;
- c) ISO 18001-2007, ekuivalente me ISO 45001-2018(e vlefshme). Sistemi i Menaxhimit per Shendetin dhe Sigurine ne Pune
- d) ISO 50001-2018, Sistemi i Menaxhimit te Energjise
- e) PAS 99:2012, Sistemi i Menaxhimit te Integruar

Shënim: Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

Shënim: Operatoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qera ose kontrate bashkepunimi

- 1 (nje) Pajisje per matjet gjeodezike GPS
- 1 (nje) Pajisje per matje gjeodezike Total Station
- 1 (nje) Automjet 4x4
- 1 (nje) Dron per matje Gjeodezike Me Sistem Lidar
- 1 (nje) Lazer Skaner Levizes (Slam)

Per plotesimin e kesaj kerkese duhet te paraqitet nje dokument i cili verteton pronesine ose aktin e marrjes me qera /kontrate bashkepunimi si dhe skeda teknike te ketyre pajisjeve .

Shënim: Sqarojme se ne permbushjen e kriterit te sipercituar , operatoret ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimitsipas shtojces nr. 10 ku te deklarohet dispionimi i mjeteve

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Paisjet topografike jane te nevojshme per nxjerrje kuotash, piketim aksesh ne rruge, nxjerrje volumesh etj. Automjeti eshte per transport stafi meqenese objektet jane te shperndara dhe ne terrene te veshtira.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

- Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës, duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termat e references jane hartuar nga komisioni i ngritur me urdher te titullarit per hartimin e detyrave te projektimit , hartimin e preventivit si dhe detajimit te llogaritjes se vleres se studim - projektimit me objekt :

- *""Asfaltim i rruges Karkanjoz-Tomorr i Madh- Tomorr i Vogel” , BASHKIA POLIÇAN*
- *"Asfaltim i rruges se brendeshme te Fshatit Kapinove” , BASHKIA POLIÇAN*
- *"Ndertimi i rruges lidhese "Mbrakull – Rruga e Re Berat - Skrapar”*
- *"Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rruges Gradisht-Peshtan NJA Vertop" , Bashkia Poliçan*

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti " Studim hartim projektesh”me objekt

- *Asfaltim i rruges Karkanjoz-Tomorr i Madh- Tomorr i Vogel” , BASHKIA POLIÇAN*
- *"Asfaltim i rruges se brendeshme te Fshatit Kapinove” , BASHKIA POLIÇAN*
- *"Ndertimi i rruges lidhese "Mbrakull – Rruga e Re Berat - Skrapar”*
- *"Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rruges Gradisht, Peshtan NJA Vertop" , Bashkia Poliçan*

Qëllimi i shërbimeve:

1. *"Asfaltim i rruges Karkanjoz-Tomorr i Madh- Tomorr i Vogel"* , Bashkia Poliçan

Synimi i këtij investimi është sistemimi i këtij segment rrugor i cili shtrihet në terren malor. Kjo rrugë lidh Banoret e ketyre fshatrave me fshatin Karkanjoz dhe me rrugen nacionale Berat-Polican . Gjerësia e mesatare e rrugës duhet të jete **4.5 m** asfalt dhe bankine ne nje krahe ose dy , sipas vendit si dhe gjatësia e saj është a f e r s i s h t **L=8.0 km** me fillim te ne fshatin Karkanjoz dhe me përfundim ne fshatrat Tomorr i Vogel dhe Tomorr i Madh. Kjo rrugë lidh Banoret e ketyre fshatrave me fshatin Karkanjoz dhe me rrugen nacionale Berat-Polican Disiplinimi i ujerave te shiut dhe ujerave qe vijne te bëhet nëpërmjet kanaleve dhe veprave të artit. Ku shihet e nevojshme te ndertohen dhe mure mbajtes apo Prites. Vlen të theksojme Gjate Projektimit te rruges te kihet parasysh disa parametra:

- Rruga duhet te jete me 1 korsi me 3-3.5 m asfalt
- Te parashikohet Pakete e Plote me nenbaze dhe baze
- Asfalti te jete min 8 cm i ndare ne pakete 5 binder + 3 tapet ,ose 8 cm mix.

Kjo rruge do te Krijoje nje nyje shume te mire lidhese dhe do te shkurtoj kohen e banoreve te ketyre zonave per tu lidhur me Rrugen Kryesore. Në mënyre indirekte përfitojne dhe banore të tjerë. Parashikohet te ndikojte ne permiresimin e infrastruktures rrugore e cila çon drejtperdrejte ne përmirësimin njëkohësisht te banorëve si dhe bizneseve dhe ne rritjen e cilesise se jeteses.

Rruga do te jete me nje kalim dhe me gjatësi rreth 8.5 km qe parashikohet në këtë detyre projektimi. Ne pjese te vecanta do ndertohen zgjerime per kembimin e automjeteve.

Aktualisht këto rruge kanë nje trup ku gjerësia do të jetë sipas përshkrimit për secilen segment të. Kjo rruge do te kete nje gjeresi asfaltit rreth 3-3.5 m, me bankina ne 2 anet e saj ose 1 ane, kjo ne varesi te terenit.

2. *"Asfaltim i rruges se Fshatit Kapinove"* , Bashkia Poliçan,

Synimi i këtij investimi është sistemimi i këtij segment rrugor shtrihet në terren Kodrinor. Gjerësia e mesatare e rrugës duhet të jete **3.5 m** asfalt dhe bankine ne nje krahe ose dy , sipas vendit si dhe gjatësia e saj është a f e r s i s h t **L=1.8 km** me fillim ne fshatit Kapinove dhe me përfundim ne Lagjet e brendshme te fshatit Kapionve.. Kjo rrugë lidh Banoret e fshatit me rrugen Polican-Tomorr Disiplinimi i ujerave te shiut dhe ujerave qe vijne te bëhet nëpërmjet kanaleve dhe veprave të artit. Ku shihet e nevojshme te ndertohen dhe mure mbajtes apo Prites. Vlen të theksojme Gjate Projektimit te rruges te kihet parasysh disa parametra:

- Rruga duhet te jete me 1 korsi me 4-4.5 m asfalt
- Te parashikohet Pakete e Plote me nenbaze dhe baze
- Asfalti te jete min 8 cm i ndare ne pakete 5 binder + 3 tapet ,ose 8 cm mix.
- Te shikohet mundesia e ndricimit ne ato pjese ku duket e nevojshme.
- Te sistemohen Ujerat e Bardha

Disiplinimi i ujerave te shiut dhe ujerave qe vijne te bëhet nëpërmjet kanaleve dhe veprave të artit. Ku shihet e nevojshme te ndertohen dhe mure mbajtes apo Prites.

3. "Ndertimi i rruges lidhese "Mbrakull – Rruga e Re Berat - Skrapar"

Qeveria Shqiptare ka Miratuar Projektin per Ndertimin e Rruges Berat-Polican-Skrapar, e cila do te kaloje ne nje gjurme te re. Nga Projekti qe disponojme eshte pare e nevojshme qe te ndertohet nje rruge lidhese midis rruges ekzistuese dhe rruges se re qe do te ndertohet. Ky segment rrugor do te shtrihet ne terren Fushor me pak pjerrtesi. Gjerësia e mesatare e rrugës duhet te jete 7 m si dhe gjatësia e saj është afersisht $L=1.2$ km me fillim te degëzimi në rrugën e Ekzistuese ne fshatin Mbrakull dhe me përfundim te lidhja me rrugen e re qe do ndertohet. Kjo rrugë lidh qytetin e Policanit si dhe fshatrat aty afer me aksin e ri te rruges. Disiplinimi i ujerave te shiut dhe ujerave qe vijne te bëhet nëpërmjet kanaleve dhe veprave të artit. Vlen të theksojme se në këtë aks rrugor nuk kemi linja ujësjellsi apo elektrike ndaj keto duhet te parashikohen te ndertohen. Gjate Projektimit te rruges te kihet parasysh disa parametra:

- Rruga duhet te jete me 2 korsi nga 3.5 m secila
- Rruga ne nje krahe duhet te kete Trotuar me gjeresi 2 m
- Rruga duhet te kete kanalizime KUZ DHE KUB
- Rruga duhet te kete Ndricim ne te gjithë gjatesine

Kjo rruge do te krijojë nje nyje shume te mire lidhese midis ketyre akseve dhe do te shkurtoj kohen e banoreve te qytetit te Policanit dhe fshatrave prane per tu lidhur me aksin e ri. Në mënyre indirekte përfitojnë dhe banorë të tjerë. Parashikohet te ndikojë ne permiresimin e infrastruktures rrugore e cila çon drejtperdrejte ne përmirësimin njëkohësisht te banorëve si dhe bizneseve dhe ne rritjen e cilesise se jeteses.

Rruga do te jete me dy kalime dhe me gjatësi rreth 1.2 km qe parashikohet në këtë detyre projektimi. Aktualisht këto rruge kanë nje trup ku gjerësia do të jetë sipas përshkrimit për secilen segment të. Kjo rruge do te kete nje gjeresi asfaltit rreth 7 m, me bankina ne 2 anet e saj, dhe ne njerin ane do te kete dhe Trotuar.

4. "Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rruges Gradisht, Peshtan NJA Vertop" , Bashkia Poliçan

Synimi i këtij investimi eshte sistemimi i ketij segment rrugor i cili Ky segment rrugor shtrihet në terren Malor. Gjerësia e mesatare e rrugës duhet te jete 4.5 m asfalt dhe bankine ne nje krahe ose dy , sipas vendit si dhe gjatësia e saj është afersisht $L=3.5$ km me fillim ne rrugen nacionale Berat - Poliçan ne lagjen Gradisht dhe me përfundim në fshatin Peshtan. Kjo rruge do te Krijojë nje nyje shume te mire lidhese dhe do te shkurtoj kohen e banoreve te ketyre zonave per tu lidhur me Rrugen Kryesore. Në mënyre indirekte përfitojnë dhe banorë të tjerë. Parashikohet te ndikojë ne permiresimin e infrastruktures rrugore e cila çon drejtperdrejte ne përmirësimin njëkohësisht te banorëve si dhe bizneseve dhe ne rritjen e cilesise se jeteses. Rruga do te jete me dy kalime dhe me gjatësi rreth 3.5 km qe parashikohet në këtë detyre projektimi. Ne pjese të vecanta do ndërtohen zgjerime për vendqëndrimin e automjeteve.

Aktualisht këto rruge kanë një trup ku gjerësia do të jetë sipas përshkrimit për secilen segment të. Kjo rruge do te kete nje gjeresi asfaltit rreth 4.5 m, me bankina ne 2 anet e saj ose 1 ane, kjo ne varesi te terenit. Kjo rrugë lidh banoret e fshatit Peshtan me rrugen nacionale Berat-Polican Disiplinimi i ujerave te shiut dhe ujerave qe vijne të bëhet nëpërmjet kanaleve dhe veprave të artit. Ku shihet e nevojshme te ndertohen dhe mure mbajtes apo Prites. Vlen të theksojme Gjate Projektimit te rruges te kihet parasysh disa parametra: Rruga duhet te jete me 2 korsi me 4.5 m asfalt , Te parashikohet Pakete e Plote me nenbaze dhe baze, Asfalti te jete min 8 cm i ndare ne pakete 5 binder + 3 tapet ,ose 8 cm mix. Krahas shtresave të domosdoshme të çakullit dhe të asfaltit ti kushtohet rëndësi dhe disiplinimit të ujërave që theksuam mësipër si dhe bankinat në dy anët e saj.

Shpërndarja: Brenda 4 muajve nga lidhja e kontrates.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bashkia Polican

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

NJESIA E PROKURIMIT